



## RISHPALLJE TERMAT E REFERENCËS

POLIS është organizatë joqeveritare, jo fitimprurëse dhe e paanëshme, e cila përmes programeve të saj sektoriale synon të jetësoj qeverisjen e mirë lokale, duke ndikuar në rritje të transparencës gjatë politikbërjes dhe vendimmarrjes publike, ushtrim ndikimi tek institucionet publike për llogaridhënie efektive, si dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve duke ndikuar në politikat lokale si dhe në ofrimin e shërbimeve sociale për kategoritë e cënueshme në kuadër Qendrës SMILE.

POLIS në partneritet me Save the Children Kosova/o është duke implementuar projektin “*Bashkë për mirëqenien e fëmijëve me nevoja të veçanta*”, i cili financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmes këtij projekti POLIS është duke mbështetur zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe lehtësimin e pasojave të COVID-19 në mirëqenien e tyre dhe familjes përmes shërbimeve multidiciplinare dhe aktiviteteve të qëndrimit ditor. Të gjitha aktivitetet në kuadër të këtij projekti zhvillohen në Lipjan.

POLIS në kuadër të këtij projekti, për të përmbushur qëllimin e projektit dhe misionin e organizatës është duke kërkuar të punësoj:

### Një (1) Fizioterapeut/e

#### 1. Përshkrim i Pozitës Fizioterapeut/e

Fizioterapeuti/ja do të jetë përgjegjës/e për ofrimin e shërbimit të fizioterapisë për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke përfshirë vlerësimin e nevojave të fëmijëve, hartimin e planeve të punës sipas qasjes multi-diciplinare; realizimin e seancave individuale dhe hartimin e raporteve të punës që dëshmojnë progresin e arritur të fëmijëve. Ai/ajo do të ofroj mbështetje drejt avancimit dhe ruajtjes së zhvillimit fizik, përmes mirëmbajtjes fizike dhe pavarësimit në shkatësitë ditore personale. Vendi i punës është në Lipjan.

#### 1.1 Detyrat dhe përgjegjësitë

- Vlerëson nevojat dhe përcakton masat dhe veprimet për përmirësimin e parametrave fizike e psikik të fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Identifikimi i përfutësve potencial të shërbimit dhe vlerësimi i nevojave të tyre;
- Përpilimi i planeve individuale sipas parimeve të qasjes multi-diciplinare;
- Shërbimet për ndihmën motorike që synojnë përvetësimin e qëndrimit vertikal, ecjen e hershme, lëvizshmëri të gjymtyrëve të poshtme/sipërme, shkathtësi të lëvizjes dhe rritjen e volumit respirator;
- Zhvillimin dhe progresin në ecje dhe sigurimin e qëndrueshmërisë vertebrale të fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Zhvillimin e sistemit motorik të fëmijës;
- Zhvillimin e fëmijës për të realizuar sjellje tipike në përputhje me rregullat dhe nivelin e zhvillimit të fëmijës;
- Realizimin e zhvillimit psikomotorik të fëmijës nëpërmjet shërbimeve që ofrohen nga specialistët dhe kujdestarët;
- Shërbimet ushtrimore në sallën e fizioterapisë synojnë tensionimin e muskujve të dëmtuar





Funded by  
the European Union

- për të rritur ndjeshmërinë e nervave lëvizore, përmes seancave ushtrimore;
- Hartimi i raporteve periodike të progresit dhe dorëzimi i tyre me kohë;
- Realizon sesione informuese me prindërit e fëmijëve përfitues, rreth mbështetjes së zhvillimit fizik të fëmijëve të tyre;
- Punë të tjera në kuadër të aktiviteteve të projektit.

### 1.2 Kualifikimet dhe përvoja:

- Diplomë universitare, në Fizioterapi (e obligueshme);
- Licencë nga Ministria e Shëndetësisë (jo e obligueshme);
- Përvojë paraprake pune në pozita të ngjashme (përparësi kanë kandidatët me përvojë në fushën e aftësisë së kufizuar);
- Shkathësi të mira të komunikimit dhe organizimit;
- Qasje gjithëpërfshirëse ndaj aftësisë së kufizuar;
- Shkathësi të mira ndër-personale dhe punës ekipore;
- Të jetë i familjarizuar me qasjen multi-diciplinare;
- Të ketë njohuri mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijëve; dhe atë të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Aftësi të mira në hartimin e planeve dhe raporteve të punës;
- Qasje pozitive në zgjidhjen e problemeve;
- Aftësi për të punuar nën presion të kohës dhe për t'i respektuar afatet kohore;

### DOKUMENTET PËR APLIKIM:

- Curriculum Vitae (CV);
- Letër e motivimit që argumenton përshtatshmërinë e kandidatit me pozitën e hapur;
- Të paktën dy referenca nga punëdhënësi/bashkëpunëtorët e mëparshëm;
- Kopjen e diplomës së nivelit më të lartë të edukimit;
- Çertifikatën që dëshmon se kandidati nuk është nën hetime (në rast të përzgjedhjes)

### PERIUDHA E FILLIMIT TË PUNËS:

- Angazhimi i Fizioterapeutit/es pritet të filloj nga data 08.08.2022.

***Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-në, letrën e motivimit, kopjen e diplomës; dhe referencat në: [info@polis-ks.org](mailto:info@polis-ks.org)***

***Ju lutemi që ta cekni në titull Pozitën për të cilën aplikoni:***

***Do të kontaktohen vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë.***

***Afati për aplikim: 02 Gusht 2022, deri në orën 23:59.***



Public Organization  
for Local Initiatives and Supports  
POLIS



Save the Children